

Oda e Stomatologëve të Kosovës
Prishtinë

Raport i Audituar Financiar

Për vitin fiskal që përfundon
më 31 Dhjetor 2021

Përmbajtja	Faqe
Raporti I Auditorit të Pavarur	2-3
Pasqyra e Gjendjes Financiare	4
Pasqyra e të Ardhurave	5
Pasqyra e Ndryshimeve në Ekuitet	6
Pasqyra e Rrjedhës së Parasë	7
Shënime mbi Pasqyrat Financiare	8-16

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Menaxhmentin e Odës së Stomatologëve të Kosovës

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Odës së Stomatologëve të Kosovës (tutje i referohemi si Oda ose OSK) të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datë 31 Dhjetor 2021, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e rrjedhes së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe shënimet në pasqyrat financiare, duke përfshirë një përmbledhje të rëndësishme kontabël.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Odës me datën 31 Dhjetor 2021, dhe rezultatin e saj financiar dhe rrjedhën e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen në mënyrë më të detajuar në paragrafin 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare' në këtë raport. Ne jemi të pavarur nga Oda në përputhje me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë (Kodi BSNEK) dhe me kërkesat etike që janë relevante për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodin BSNEK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiarë (SNRF), dhe për kontrollet e brendshme, në masën që përcaktohet nga menaxhmenti, është i nevojshëm për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimeve apo gabimeve.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Odës për të vazhduar aktivitetin, duke i shpalosur, kur është e aplikueshme, çështjet në lidhje me vazhdimin e aktivitetit dhe përdorimin e kontabilitetit me parim të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon ta likuideojë Odën ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternative tjetër reale përveç se ta bëjë këtë.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Odës.

Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe sigurojmë evidencë të auditimit të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku I mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa rreziku që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime apo shkelje të kontrolleve të brendshëm.
- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për auditim me qëllim të dizajnit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të Odës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim një përfundim lidhur me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës së kontabilitetit mbi parimin e vijimësisë nga menaxhmenti, në bazë të evidencave të auditimit të siguruar, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse mbi parimin e vijimësisë të Odës. Nëse arrijmë në përfundim se ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit për shpalosjet përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse këto shpalosje janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të siguruar deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte në të ardhmen mund të ndikojnë që Oda të ndërpres veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një paraqitje të drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Odës përveç të tjerash, edhe përfushëveprimin e planifikuar dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme të kontrollit të brendshëm që ne kemi identifikuar gjatë auditimit.

“ Audit Check ” shpk

Haxhi Nimanaj, auditor ligjor

Data, 02.09.2022



“ODA E STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS”

Pasqyrat Financiare, politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese
për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2021

RAPORTI FINANCIAR VJETOR

Oda e Stomatologëve të Kosovës

Nr. Fiskal: 601733646


Adresa: Rr:Ukshin Hoti Nr:4

Qyteti: Prishtinë


Pasqyra e pozitës financiare
më 31 dhjetor 2021

	Shënimi	2021	2020
PASURITË			
Pasuritë afatshkurtra			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	4	130,898	73,369
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	5	9,513	5,090
Pasuritë e tjera afatshkurtra	5.1.	470	26
Gjithsej pasuritë afatshkurtra		140,879	78,484
Pasuritë afatgjata			
Prona, pajisjet dhe impiantet	7	3,112	3,328
Gjithsej pasuritë afatgjata		3,112	3,328
Gjithsej pasuritë		143,990	81,812
DETYRIMET DHE EKUITETI			
DETYRIMET			
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	8	478	15
Tatimin e pagueshme		1,082	2,367
Detyrimet për të hyrat e shtyera		3,700	37,591
Detyrimet e tjera afatshkurtra		941	
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		6,199	39,972
Detyrimet afatgjata			
Gjithsej detyrimet afatgjata		0	0
Gjithsej detyrimet		6,199	39,972
EKUITETI			
Fitimet (Humbjet) e mbajtura	10.1.	137,792	41,839
Gjithsej ekuiteti		137,792	41,839
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		143,990	81,812

Prof.Dr.Blerim Kamberi
Kryetar në OSK



Agron Kabashi
Zyrtar i Fainancave në OSK



“ODA E STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS”

**Pasqyrat Financiare, politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese
për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2021**

**Pasqyra e të ardhurave
për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021**

	Shënimi	2021	2020
Të hyrat	11	203,072	76,355
Kostoja e shitjes	12	0	0
Fitimi / (humbja) bruto		203,072	76,355
Të ardhurat tjera	11.1.		
Shpenzimet e pagave bruto	13	64,314	56,149
Shpenzimet e zyrës & administratës	14	4,171	2,408
Shpenzimet e Kuvendit të OSK		860	0
Shpenzimet e Konferencës së OSK		11,299	0
Shpenzimet e derivateve		1,300	946
Shpenzimet e perfaqesimit		1,366	690
Shpenzimet per faksimila		12,346	
Shpenzimet qirase		2,923	
Shpenzimet e telefonit		430	
Shpenzimet komunale		272	
Shpenzimet obeliskut		5,569	
Shpenzimet tjera	14	424	5,623
Shpenzimet e zhvlersimit		1,225	1,075
Gjithsejt shpenzimet operative		106,500	66,891
Fitimi / (humbja) operativ		96,572	9,464
Shpenzimet financiare	15	583	361
Të ardhurat financiare	15	0	0
Fitimi / (humbja) i/e vitit		95,989	9,104

Prof.Dr.Blerim Kamberi
Kryetar në OSK



Agron Kabashi
Zyrtar i Fainancave në OSK



“ODA E STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS”
Pasqyrat Financiare, politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese
për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2021

Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet
për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021

	Fitimet e mbajtura	Gjithsej
Gjendja më 1 janar 2020	33,017	33,017
Fitimi / (humbja) i/e vitit	9,104	9,104
Deponimet / (Terheqjet)	(281)	(281)
Gjendja më 31 dhjetor 2020	41,839	41,839
Gjendja më 1 janar 2021	41,839	41,839
Fitimi / (humbja) i/e vitit	95,989	95,989
Deponimet / (Terheqjet)	(37)	(37)
Gjendja më 31 dhjetor 2021	137,792	137,792

“ODA E STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS”
Pasqyrat Financiare, politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese
për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2021

Pasqyra e rrjedhjes së parasë
për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021

	Shënimi	2021	2020
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi / (humbja) para tatimit		95,989	9,104
Rregullimet për zërat jo në para të shpenzimeve dhe të hyrave			
Zhvlërësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve	7	792	1,075
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative		96,781	10,179
Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative			
(Rritja) / zvogëlim në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	5	(4,423)	0
(Rritja) / zvogëlimi në pasuritë e tjera	5.1	(444)	0
Rritja / (zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	8	463	0
Rritja / (zvogëlimi) në detyrimet e tjera	9	(34,237)	443
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative		58,140	10,622
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese			
Pagesat për blerjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve	7	(612)	(1,674)
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese		(612)	(1,674)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese			
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese		0	0
Rritja/(zvogëlimi) neto i parasë dhe ekuivalentëve të parasë		57,528	8,948
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	4	73,369	64,421
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit	4	130,898	73,369

“ODA E STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS”

**Pasqyrat Financiare, politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese
për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2021**

1. Informata të përgjithshme

Oda e Stomatologëve të Kosovës (OSK) është një OJQ e regjistruar në Atk me date 25.01.2017 me Nrf: 601733646 e themeluar në bazë të Ligjit Nr:04/L-150 Për Odat e Profesionstëve Shëndetesor

Adresa e regjistruar e zyrës dhe vendi bazë i afarizmit është Rr:Ukshin Hoti Nr:4 Prishtinë.

Oda e Stomatologëve e Kosovës është organizatë e pavarur profesionale e stomatologëve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre profesionale në Republikën e Kosovës.

Oda përfaqëson dhe mbron interesat e përbashkëta të anëtarëve të saj dhe vendos standarde të larta të kodit etik të detyrueshëm për çdo stomatolog që ushtron profesionin e tij.

“ODA E STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS”

Pasqyrat Financiare, politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2021

II. ADOPTIMI I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË REJA DHE ATYRE TË RISHIKUARA PËR RAPORTIM FINANCIAR

Standardet dhe interpretimet në fuqi në periudhën e raportuar

Ndryshimet e mëposhtme të standardeve ekzistuese të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe interpretimet e publikuara nga Komiteti i Interpretimeve të Raportimeve Financiare Ndërkombëtare janë në fuqi për periudhën raportuese (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2021):

- **Ndryshimet në fazën e dytë të reformës në Librin e Regjistrimëve të Investimeve (IBOR)**
Më 27 Gusht 2020, BSNK lëshoi 'Reformën e Referencës së Normës së Interesit - Faza 2 (Ndryshimet në SNRF 9, SNK 39, SNRF 7, SNRF 4 dhe SNRF 16) me ndryshime që adresojnë çështje që mund të ndikojnë në raportimin financiar pas reformës se një pike referimi të normës së interesit, duke përfshirë zëvendësimin e saj me pike referimi të normës alternative. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 Janar 2021.
- **Ndryshimet në SNRF 4 Kontratat e Sigurimit** - një përjashtim i përkohshëm opsional nga zbatimi i SNRF 9 për njësitë ekonomike veprimtaria mbizotëruese e të cilave është lëshimi i kontratave brenda objektit të SNRF 4.
- **Ndryshimet në SNRF 16**
Më 31 Mars 2021, BSNK publikoi 'Koncesionet e Qirasë të Lidhura me Covid-19 përtej 30 Qershorit 2021 (Amendamenti i SNRF 16)' që zgjat, për një vit, ndryshimi i Majit 2020 që u ofron qiramarrësve një përjashtim nga vlerësimi nëse një koncesion i qirasë i lidhur me Covid-19 është një modifikim i qirasë. Amendamenti është efektiv për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas datës 1 Prill 2021.

Standardet dhe interpretimet në fjalë nuk janë ende efektive

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare të veçanta standardet, përmirësimet dhe interpretimet e mëposhtme ishin publikuar por akoma në fuqi.

- **Cikli vjetor i përmirësimeve 2018-2020**
Më 14 Maj 2020, BSNK lëshoi 'Përmirësimet Vjetore të Standardeve të SNRF 2018-2020'. Deklarata përmban ndryshime në katër Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) SNRF 1, SNRF 9, SNRF 16 dhe SNK 41 si rezultat i projektit vjetor të BSNK-së për përmirësime. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2022.

Standardi	Ndryshimet në standard
SNRF 1 - Adoptimi për herë të parë i SNRF-ve	Filial si adoptues për herë të parë dhe përjashtimi vullnetar në lidhje me dallimet kumulative të përkthimit
SNRF 9 - Instrumentet Financiare	Tarifat në testin “10 për qind” për çregjistrimin e detyrimeve financiare.
Shembuj ilustrues të SNRF 16 - Qiratë	Stimujt e qirasë
SNK 41 - Agrikultura	Tatimi në matjen e vlerës së drejtë

“ODA E STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS”

Pasqyrat Financiare, politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2021

- **Ndryshimet në SNK 16 në lidhje me të ardhurat para përdorimit të synuar**
Më 14 Maj 2020, BSNK lëshoi 'Pronë, Impiant dhe Pajisje - Të ardhura para përdorimit të synuar (Ndryshime në SNK 16)' në lidhje me të ardhurat nga shitja e artikujve të prodhuar ndërsa sillte një aktiv në vendin dhe gjendjen e nevojshme që ai të jetë i aftë të veprojë në mënyrën e synuar nga menaxhmenti. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2022.
- **Ndryshimet në SNK 37 në lidhje me kontratat me kushte rënduese (Onerous Contracts)**
Më 14 Maj 2020, BSNK lëshoi 'Kontratat me kushte rënduese - Kostoja e Përbushjes së Kontratës (Ndryshime në SNK 37)' duke ndryshuar standardin në lidhje me kostot që një kompani duhet të përfshijë si koston e përbushjes së një kontrate kur vlerëson nëse një kontratë është me kushte rënduese. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022.
- **Ndryshimet në SNRF 3 që azhurnojnë një referencë në Kornizën Konceptuale**
Më 14 Maj 2020, BSNK lëshoi 'Referencën në Kuadrin Konceptual (Ndryshimet në SNRF 3)' me ndryshimet në SNRF 3 'Kombinimet e Biznesit' që azhurnojnë një referencë të vjetëruar në SNRF 3 pa ndryshuar ndjeshëm kërkesat e tij. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2022.
- **Ndryshimet në SNK 1 Klasifikimin e Detyrimeve si afatshkurta ose afatgjata**
Më 23 Janar 2020, BSNK lëshoi 'Klasifikimin e Detyrimeve si afatshkurta ose afatgjata (ndryshimet në SNK 1)' duke siguruar një qasje më të përgjithshme për klasifikimin e detyrimeve sipas SNK 1 bazuar në marrëveshjet kontraktuale në vend në datën e raportimit. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022, megjithatë, data e tyre efektive është shtyer në 1 janar 2023.
- **Ndryshimet në SNRF 17 Kontratat e Sigurimit**
Më 25 Qershor 2020, BSNK lëshoi 'Ndryshime në SNRF 17' për të adresuar shqetësimet dhe sfidat e zbatimit që u identifikuan pasi SNRF 17 'Kontratat e Sigurimit' u publikua në 2017. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2023.
- **Ndryshimet në SNK 1 dhe Deklarata e Praktikës së SNRF 2**
Më 12 Shkurt 2021, BSNK publikoi "Shpalosja e Politikave Kontabël" me ndryshime që synojnë të ndihmojnë përgatitësit të vendosin se cilat politika kontabël duhet të shpalosin në pasqyrat e tyre financiare. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 Janar 2023.
- **Ndryshime në SNK 8 - Vlerësimet Kontabël**
Më 12 Shkurt 2021, BSNK publikoi 'Përkufizimin e Vlerësimeve Kontabël' për të ndihmuar njësitë ekonomike të bëjnë dallimin midis politikave kontabël dhe vlerësimeve kontabël. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 Janar 2023.
- **Ndryshimet në SNK 12 – Tatimi i Shtyrë**
Më 7 Maj 2021, BSNK publikoi 'Tatimi i Shtyrë në lidhje me Asetet dhe Detyrimet që rrjedhin nga Një Transaksion i Vetëm' që sqaron se si kompanitë llogarisin tatimin e shtyrë për transaksione të tilla si qiratë dhe detyrimet e nxjerrjes jashtë përdorimit. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 Janar 2023.

Miratimi i këtyre ndryshimeve në standardet dhe interpretime ekzistuese nuk kanë ndikuar në politikat kontabël të Odës.

**III. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL
dhe Shpalosja e Pasqyrave Financiare per vitin 2021**

Bazat e përgatitjes dhe politikat kontabël

Deklarata e pajtueshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në pajtim me Standardet Ndërkombëtare për Raportimit Financiar (SNRF) të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

Baza e matjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në baza historike të kostos përveç rivlerësimit të pasurisë së caktuar për asete dhe detyrime të caktuara që janë vlerësuar me vlerën reale.

Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat Financiare janë paraqitur në njësi monetare Euro (€), cila është edhe monedha funksionale për Odën. Euro (€) është valuta kombetare në Kosovë.

7. Prona, impiantet dhe pajisjet

Prona, pajisjet dhe impiantet janë matur me kosto minus zhvlerësimi i akumuluar dhe çdo humbje e akumuluar nga dëmtimi (rënia në vlerë).

Zhvlerësimi ngarkohet në mënyrë që të ndahet kosto e pasurive minus vlera e tyre e mbetur përgjatë jetës së përdorimit të parashikuar, duke përdorur metodën lineare. Normat vjetore të mëposhtme janë përdorur për zhvlerësimin e pronës, impianteve dhe pajisjeve:

Ndërtesat 5%

Pajisjet, mobilieritë, kompjuterët 20%

4. Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë të holla në bankë dhe në dorë. Për qëllime të rrjedhës së parasë, paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë para në dorë dhe të parave të gatshme të mbajtura në bankat, duke përfshirë depozitat me afat maturimi më pak se tre muaj.

5. Të arkëtueshme dhe kerkesat tjera tregtare

Të arkëtueshmet tregtare janë regjistruar fillimisht me shumën e arkëtuar kundrejt shitjes së produkteve. Më pas të arkëtueshmet tregtare janë dhënë në koston nominale minus lejimi për borxhet e dyshimta.

27. Njohja e të Hyrave

Të hyrat nga shitja e mallrave njihen kur mallrat janë dorëzuar dhe pronësia është bartur.

Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme. Të ardhurat zvogëlohen për kthimet e konsumatorëve, zbritjet dhe lejimet tjera të ngjashme.

15. Detyrimet

Një detyrim njihet në qoftë se, si rezultat i ngjarjeve në të kaluarën, Odës i lindin detyrime ligjore ose konstruktive të cilat mund të parashikohen me besueshmëri dhe është e mundur që të ndodhë një dalje e përfitimeve ekonomike për shlyerjen e detyrimit.

15. Llogarit e pagueshme

Llogaritë e pagueshme tregtare janë detyrime në bazë të afateve normale të kreditimit dhe nuk bartin interes. Të pagueshmet tregtare të shprehura në monedhë të huaj shprehen në valutën Euro duke përdorur kursin e këmbimit në datën e raportimit. Fitimet ose humbjet e këmbimit valutor janë të përfshira në të ardhurat e tjera apo shpenzimet e tjera.

Llogarit e Pagueshme njihen kur shuma është e përcaktueshme dhe obligimi për te paguar këtë shume ekziston si rezultat i veprimtarive ekonomike. Ato paraqiten sipas kostos.

30. Shpenzimet e periudhës

Shpenzimet janë njohur në momentin e ndodhjes

Shpenzimet operative dhe shpenzimet tjera njihen në Pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në datën e kryerjes së shërbimit, marrjes së përfitimit ose në datën e origjinës.

Kostot e huamarrjes

Të gjitha kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në periudhën në të cilën kanë ndodhur.

“ODA E STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS”

**Pasqyrat Financiare, politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese
për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2021**

7. Prona, Paisjet dhe Makineritë

	Pajisjet, Veturat, kompjuterët etj	Inventari	Pasurite e patrupzuara	Gjithsej
Kostoja				
Më 01 Janar 2020	1,825	1,877	-	3,702
Shtesat gjatë vitit 2020		1,084	590	1,674
Shlyerjet gjatë vitit 2020			-	-
Më 31 Dhjetor 2020	1,825	2,961	590	5,376
Zhvlerësimi i akumuluar dhe dëmtimi				
Më 01 Janar 2020	365	608	-	973
Zhvlerësimi I vitit 2020	365	592	118	1,075
Shlyerjet gjatë vitit 2020			-	-
Më 31 Dhjetor 2020	730	1,200	118	2,048
Vlera neto me 31 dhjetor 2020	1,095	1,761	472	3,328
Shtesat gjatë vitit 2021		576		576
Shlyerjet gjatë vitit 2021			-	-
Më 31 Dhjetor 2021	1,095	2,337	472	3,904
Zhvlerësimi I vitit 2021	792			792
Shlyerjet gjatë vitit 2021			-	-
Kosto me 31 Dhjetor 2021	1,825	3,537	590	5,952
Gjithsejt Zhvlerësimi akumuluar	1,522	1,200	118	2,841
Vlera neto me 31 dhjetor 2021	303	2,337	472	3,112

4.Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Pershkrimi	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2021	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2020
	€	€
Paraja në bankë Nib	124,585	69,301
Paraja në bankë Nib-solidaritetit	6,313	4,068
Gjithsej Paraja dhe Ekuivalentet e saj	130,898	73,369

6. Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera

Pershkrimi	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2021	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2020
	€	€
Llogaritë e arkëtueshme vendore	9,513	5,090
Të arkëtueshmet tjera	470	26
Gjithsej llogaritë e arketushme	9,983	5,116

“ODA E STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS”
Pasqyrat Financiare, politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese
për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2021

Detyrime afatshkurtëra

15. Llogarite e pagueshme

Pershkrimi	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2021	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2020
	€	€
Llogaritë e pagueshme mbrenda vendit	478	15
Gjithsej llogarite e pagueshme -1	478	15
Të pagueshmet tjera afatëshkurta		
Pagat e pagushme	941	
Tatimin në paga i pagueshem	500	1,105
Kontributi në paga i pagueshem	582	1,262
Te hyrat e shtyera	3,700	37,591
Gjithësejt të pagueshmet tjera	5,722	39,958
Gjithsej detyrimët afatëshkurta	6,201	39,973

27. Te hyrat

Pershkrimi	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2021	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2020
	€	€
Të hyrat nga Anëtarsimi	58,450.00	43,325.00
Të hyrat nga Licencimi dhe Ri-Licencimi	47,320.00	26,840.00
Të hyrat nga vërtetimi për Kod Etik	690.00	720.00
Të hyrat nga organizimi i Konferencave	27,680.10	
Të hyrat nga EVP dhe hulumtimet	3,584.00	1,815.00
Të hyra nga taksa për regjistrim	1,735.00	440.00
Të hyra nga taksa për valorizim	865.00	
Te hyrat nga provimet vlersuses	2,400.00	1,800.00
Te hyrat nga solidariteti	-	995.00
Te hyrat nga faksimilat	23,806.00	
Te hyrat nga te hyrat e shtyra	32,501.00	
Te hyrat nga gjobat	2,835.00	
Te hyra tjera	1,206.00	420.00
Gjithsej te hyrat	203,072.10	76,355.00

“ODA E STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS”
Pasqyrat Financiare, politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese
për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2021

30. Shpenzimet Operative

Pershkrimi	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2021	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2020
	€	€
Shpenzimet për Paga	61,348.34	53,494.67
Shpenzimet e Kontributeve Pensionale	2,965.75	2,654.00
Shpenzimet e Kuvendit të OSK	860.00	
Shpenzimet e Konferencës së OSK	11,298.90	
Shpenzimet e anëtarimit në FDI dhe ERO	-	484.88
Shpenzimet e derivateve	1,299.99	945.98
Shpenzimet e perfaqesimit	1,365.60	205.14
Shpenzimet e materialeve për zyre	4,170.59	1,887.95
Shpenzime qirase	2,923.06	
Shpenzimet per faksimila	12,346.35	
Shpenzimet e telefonit dhe internetit	430.45	443.39
Shpenzimet komunale	272.34	77.00
Provizionet bankare	583.00	360.80
Shpenzimet per obelisk te odave	5,569.33	
Shpenzime per perkrahje solidare	-	1,400.00
Shpenzime tjera	424.00	4,223.00
Shpenzimet zhvlersimit	1,225.30	1,075.00
Gjithsej shpenzimet operative	107,083.00	67,251.81

IV. Vlera e drejtë dhe menaxhimi i rrezikut

Menaxhmenti i Odës konsideron se vlerat kontabël të asetëve financiare dhe detyrimeve financiare të regjistruara me kosto ose kosto të amortizuara në pasqyrat financiare ngjajnë me vlerën e tyre reale për shkak të maturitetit të tyre të shkurtër.

Menaxhimi i rrezikut

Korniza e menaxhimit të rrezikut

Politikat e menaxhimit të rrezikut të Odës janë vendosur për të identifikuar dhe analizuar rreziqet me të cilat përballlet Oda, për të vendosur limitet dhe kontrollet e përshtatshme, dhe për të monitoruar rreziqet dhe zbatimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e menaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut, produktet dhe shërbimet e ofruara. Oda, përmes standardeve dhe procedurave të menaxhimit synon të zhvillojë një ambient kontrolli konstruktiv dhe të disiplinuar në të cilin gjithë punonjësit i kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre. Drejtimi kryen monitorimin e përditshëm për të gjitha pozicionet e aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurat dhe shpenzimet, duke zbatuar praktikatat me të mira.

Palët e lidhura

Oda nuk ka hyrë në transaksione me palët e lidhura gjatë vitit 2021

Zotimet

Më 31 dhjetor 2021, Oda nuk ka pasur zotime.

Detyrimet kontingjente

Nuk ka raste të evidentuara të gjykatës ose depozita lidhur me odën, drejtorët ose punëtorët e odës që mund të rezultojë me detyrime në të ardhmen.

Ngjarjet pasuese

Nuk ka ngjarje pas datës së pasqyrës së pozicionit financiar që kërkon korrigjime ose shpalesje në pasqyrat financiare.

Aprovimi i pasqyrave financiare

Pasqyra financiare janë aprovuar nga menaxhmenti dhe janë autorizuar për publikim me date 30.03.2022.